

## A- Sistemi i Akreditimit

**Sistemi i Akreditimit** të Arsimit të Lartë në Shqipëri është ngritur me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.303, dt. 01.07.1999, bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr. 8461, datë 25.02.1999

Sistemi i Akreditimit ka për funksion:

- Vlerësimin dhe Akreditimin e Institucioneve dhe Programeve ekzistuese të Arsimit të Lartë (AL)
- Vlerësimin dhe Akreditimin paraprak të kurseve të studimit dhe njësive të reja të AL.

Institucionet e Akreditimit janë: Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë (**AAAL**) dhe Këshilli i Akreditimit (**KA**), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (**MASH**).

**Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë** është institucion publik, buxhetor në varësi nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. **AAAL** është institucioni përgjegjës për Vlerësimin e Cilësisë në AL. **AAAL** harton kriteret dhe procedurat e Vlerësimit të Cilësisë në AL, të cilat pas një procesi këshillimi me Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), ia paraqet për miratim Këshillit të Akreditimit. Kriteret, standardet dhe procedurat që hartohen nga AAAL dhe miratohen nga KA, iu bëhen të njohura të gjitha IAL. Agjencia përgatit dhe monitoron mekanizmat sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe asiston IAL për ngritjen e këtij sistemi.

**Këshilli i Akreditimit** është organ kolegjal dhe përbëhet nga 9 persona, personalitete në fusha të

ndryshme të arsimit, shkencës e ekonomisë. Anëtarët e **KA** emërohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës ndërsa Kryetari i **KA** emërohet nga Kryeministri me propozim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. KA miraton kriteret e vlerësimit në nivel programesh dhe institucional, të hartuara nga AAAL, miraton kërkesën e IAL për vlerësimin përkatës, si dhe periudhën gjatë së cilës duhet të kryhet ky vlerësim. KA vendos për rezultatin përfundimtar të vlerësimit bazuar në raportin e hartuar nga AAAL. Rezultati quhet pozitiv, kur plotësohen kriteret e aktuara. Në të kundërt quhet negativ. Këtë rezultat KA ia paraqet për vendim MASH-it.

**Ministria e Arsimit dhe Shkencës**, pas shqyrtimit të raportit të dhënë nga KA, nëse ai është negativ, merr vendimin për mbylljen ose jo të kurseve ekzistuese të studimit ose paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave mbylljen ose jo të Shkollave ekzistuese të Larta Publike, apo të strukturave të tyre përbërëse. Për Shkollat e Larta Jopublike, në qoftë se raporti i KA është negativ, kjo ministri merr vendim për mosnjohjen e kurseve ekzistuese të studimit ose i propozon Këshillit të Ministrave mosnjohjen e shkollës. Këto procedura janë të vlefshme edhe për kurset e studimit në Shkollat Pasuniversitare. Në rastin e vlerësimeve pozitive, MASH shpall nivelin e diplomës.

Sipas VKM Nr.156, datë 22.03.2001 “Për Shkollat e Larta Jopublike në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në rezultatin e vlerësimit dhe akreditimit, MASH jep të drejtën e njohjes së kursit të studimit dhe të Shkollës së Lartë Jopublike, brenda 5-vjetësh, pas marrjes së lejes dhe para përfundimit të kursit të studimit.

## B - Funkzioni i Agjencisë

**Vlerësimi i Cilësisë** në AL kryhet në nivel programesh dhe/ose në nivel institucional. Secili proces përbëhet nga Vlerësimi i Brendshëm dhe nga Vlerësimi i Jashtëm. Vlerësimi kryhet sipas procedurave të përgatitura nga **AAAL** dhe që sigurojnë paanshmëri, objektivitet dhe transparencë të procesit.

Vlerësimi i Brendshëm (ose Vetëvlerësimi) kryhet nga vetë IAL, ndërsa Vlerësimi i Jashtëm nga një grup ekspertësh që nuk kanë konflikt interesash me institucionin që vlerësohet. **AAAL** përgatit, mbi bazën e dy vlerësimeve, një raport përfundimtar që ia paraqet për vendim **KA** e **MASH**.

Një vlerësim kryhet me kërkesë të **MASH**, sipas kalendarit të vlerësimeve të **AAAL** ose kur kjo bëhet me kërkesë të një IAL që miratohet nga KA dhe AAAL. **AAAL** rregjistron kërkesat e IAL për vlerësim. Një Shkollë e Lartë Publike apo Jopublike, sipas VKM Nr.303, mund të funksionojë pa u akredituar për një periudhë jo më shumë se 4-vjeçare. Kur Shkolla e Lartë nuk e kërkon vlerësimin brenda kësaj periudhe, MASH i kërkon **AAAL** të fillojë procedurat e vlerësimit.

**AAAL** i paraqet raportin përfundimtar të vlerësimit Këshillit të Akreditimit dhe ky i fundit, pasi jep vlerësimin përfundimtar, ia paraqet këtë MASH-it, shoqëruar me rekomandimet përkatëse.

**AAAL** është përgjegjëse për shpalljen dhe botimin e rezultateve të vlerësimit sipas vendimit të marrë më parë nga KA. Për Shkollat e Larta Publike, KA vendos rast

pas rasti, për publikimin ose jo të rezultatit përfundimtar. Në rast vendimi pozitiv, KA përcakton rrugën dhe mjetin e publikimit të rezultatit të vlerësimit. Duke qenë se për Shkollat e Larta Jopublike, bërja publike e rezultatit të vlerësimit është e detyrueshme, për këto shkolla KA vendos vetëm për rrugën dhe mjetin e publikimit.

## C- Veprimtaritë e kryera nga Agjencia

**AAAL**, në bashkëpunim me ekspertë e përfaqësues të Shkollave të Larta ka hartuar dy manuale mbi të cilat bazohet vlerësimi: Manuali i Vetëvlerësimit dhe Manuali i Vlerësimit të Jashtëm.

**AAAL** ka hartuar procedurën e plotë të Vlerësimit të Cilësisë në AL, që është miratuar nga KA. **AAAL** në bashkëpunim me ekspertë të huaj dhe vendas ka përgatitur Aspektet dhe Treguesit e matshëm për Vlerësimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. **AAAL** ka hartuar gjithashtu standardet e para të Institucioneve dhe Programeve të cilat, pasi iu nënshtruan një procesi këshillimi të gjerë me IAL, janë miratuar nga **KA** dhe **MASH**.

- Në periudhën 2001-2003 janë kryer vlerësimet në nivel institucional dhe/ose programesh të: 2 diplomave në Universitetin Politeknik të Tiranës, 1 diplomë në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, 1 diplomë në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës, 1 diplomë në Universitetin Bujqësor Tiranë dhe 1 diplomë në Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër.

- Gjatë vitit 2004 është kryer vlerësimi dhe akreditimi në të gjitha Degët e Infermierisë në vend: Shkolla e Lartë e Infermierisë Tiranë, Fakulteti i Infermierisë në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, Departamenti i

Infermierisë në Universitetin "Fan.S Noli" Korgë, Departamenti i Infermierisë në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan dhe Degët e Infermierisë në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër dhe në Universitetin "Eqerem Çabej" Gjirokastrë.

- Në tetor 2004 ka filluar procesi i Vlerësimit të Cilësisë në të gjitha Degët e Mësuesisë në vend. Aktualisht po kryhet faza e vetëvlerësimit në Degët e Mësuesisë për Ciklin e Ulët dhe Parashkollor.

Në disa nga vlerësimet e kryera më parë dhe ato që po kryhen aktualisht, në Grupet e Vlerësimit të Jashtëm, janë përfshirë edhe ekspertë të huaj.

Asistenca e huaj, një pjesë të botimeve të AAAL dhe aktivitete të tjera të Sistemit të Akreditimit (KA, AAAL), janë mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë "SOROS" përmes një projekti 2-vjeçar në kuadrin e programit HESP.

Në vitin 2002, AAAL ka organizuar një Konferencë Kombëtare përmes së cilës i ka bërë të njohur mjedisit akademik Sistemin e Akreditimit, Procesin e Vlerësimit dhe rezultatet e arritura deri në atë periudhë.

AAAL mban lidhje të ngushta dhe kryen aktivitete të përbashkëta me Agjenci të tjera të Evropës e më gjerë dhe është anëtare e tre rrjeteve ndërkombëtare në fushën e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (INQAAHE, CEE-Network dhe EAIE).

## PROCESI I BOLONJES PER CILESINE

### UNIVERSITETET

- *"Fusha e Arsimit të Lartë European duhet të ndërtohet mbi vlera thellësore akademike, ndërkohë që përmbushen dhe shpresat e aktorëve d.m.th. demonstrimi i cilësisë".*
- *"Vlerësimi i cilësisë kërkon balancë midis novacionit dhe traditës, shkëlqimit akademik dhe përkatësisë sociale dhe ekonomike, koherencës së kurrikulave dhe lirisë së zgjedhjes së studentëve".*
- *"Cilësia e brendshme nuk është e mjaftueshme. Ajo duhet të demonstron dhe të garantohet në mënyrë që të njihet dhe besohet nga studentët, partnerët dhe shoqëria në vend, Europë dhe në botë". Salamanka, Mars 2001*

### MINISTRAT E ARSIMIT

- *"Cilësia e qëndron në zemër të krijimit të Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë." Berlin 2003*
- *"Cilësia është kushti bazë në themel të besimit, lëvizshmërisë, përshtatjes dhe tërheqjes në Fushën e Arsimit të Lartë.... Cilësia e Arsimit të Lartë dhe puna kërkimore janë përcaktues të rëndësishëm i konkurrencës së Institucioneve të Arsimit të Lartë". Pragë 2001*
- *"Duke iu përmbajtur parimit të autonomisë institucionale, përgjegjësia kryesore për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë lidhet me çdo institucion në veçanti dhe kjo siguron bazat për përgjegjshmëri reale të sistemit akademik brenda kuadrin kombëtar të cilësisë". Berlin 2003.*

## Stafi i Agjencisë së Akreditimit

### Drejtores:

Prof.As. Dhurata Bozo

### Specialistë:

Mimoza Kore

Çlirim Duro

Etleva Vasha

### Adresa:

Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë

Rruga "Lekë Dukagjini" Nr 5, Tiranë

Tel/Fax: +355 4 257 954

Tel/Fax: +355 4 266 302

E-mail: [aahe\\_aaal@adanet.com.al](mailto:aahe_aaal@adanet.com.al)

Website: [www.aaal.edu.al](http://www.aaal.edu.al)

## Këshilli i Akreditimit

Prof. Farudin KRUTAJ

Prof. As. Mimoza HAFIZI

Prof. Shyqyri LLACI

Prof. Vjollca IBRO

Prof. As. Dhurata BOZO

Avokat Krenar LOLOÇI

Prof. As. Erlehta MATO

Prof. Vladimir NIKA

Prof. As. Agim MUÇAJ



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS



AGJENCIA E AKREDITIMIT TE ARSIMIT TE LARTE

## AGJENCIA E AKREDITIMIT TE ARSIMIT TE LARTE

